

Të përgjithshme dhe
në tërësi për secilin
për lojtarët.
3.03.20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1035 Prot.

Tiranë, më 2 . 03 2020

Lënda: Dërgohet dekreti i Presidentit të Republikës, me nr. 11443, datë 2.03.2020.

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

Bashkëlidhur, Ju dërgojmë dekretin e Presidentit të Republikës nr. 11443, datë 2.03.2020 “Për kthimin e ligjit nr. 14/2020 “Për një shtesë në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese’, të ndryshuar”, së bashku me arsyet e kthimit të ligjit.

Ju falemnderit!

Znj. Merita Rado!
për tjetër,
03.03.20

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Ornela ZONJA



Znj. Gjallica
Për tjetër
Pë dërgo të kësaj
konstitucione



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI**

D E K R E T

**PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 14/2020
“PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 8577, DATË 10.2.2000 ‘PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS
KUSHTETUESE’, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 85, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

D e k r e t o j

Kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 14/2020 “Për një shtesë në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese’, të ndryshuar” për rishikim sipas arsytimit bashkëlidhur këtij dekreti.

**Nr. Dekretit 11443
Tiranë, më 2.03.2020**

PRESIDENTI I REPUBLIKËS



ILIR META

Arsyet e kthimit të ligjit nr. 14/2020
“Për një shtesë në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000,
“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar”

Të nderuar deputetë,

Kuvendi i Shqipërisë, në seancën plenare të datës 12 shkurt 2020, ka miratuar ligjin nr. 14/2020 “Për një shtesë në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar”. Ky ligj me shkresën nr. 664 prot, datë 14.02.2020 të Kuvendit, i është përcjellë Presidentit të Republikës për dekretim dhe shpallje.

Sipas dokumentacionit parlamentar të publikuar në faqen e Kuvendit të Shqipërisë rezulton se, projektligji është paraqitur në datën 6 dhjetor 2019 dhe është iniciuar nga tre deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë: Adnor Shameti, Alket Hyseni dhe Edmond Leka.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të praktikës parlamentare (*Relacionit shoqërues të projektligjit të propozuar nga tre deputetët, Raportit të Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*) kjo nismë është servirur si “zgjdhje e situatës” kur Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, i zgjedhur sipas nenit 125 të Kushtetutës, në rast mosveprimi të Presidentit të Republikës për të organizuar ceremoninë e betimit, të mund të fillojë ushtrimin e detyrës së tij.

Sipas dokumentacionit parlamentar, qëllimi i shtesave në ligjin nr. 8577/2000, është ofrimi i një mekanizmi për të mos penguar në të ardhmen punën e Gjykatës Kushtetuese, duke siguruar që betimi të bëhet brenda një kohe të mjaftueshme, pa cenuar fillimin e ushtrimit të detyrës nga ana e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Projektligji fillestar i propozuar nga tre deputetët iniciatorë përmbante gjithsej 3 nene, ku përveç kufizimeve dhe procedurës së re antikushtetuese të betimit që parashikohej në nenin 1 të tij, në nenin 2, parashikohej që ligji të kishte efekt prapaveprues në mënyrë që çdo person i zgjedhur/emëruar, apo i konsideruar i emëruar si anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe që nuk kishte bërë betimin, do të betohej sipas dispozitave të këtij ndryshimi në ligj, sapo ky propozim të hynte në fuqi.

Para së gjithash, siç dhe Kuvendi është në dijeni, vlen të theksohet se, të gjithë anëtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese, të emëruar apo të zgjedhur nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë kanë bërë betimin përpara Presidentit të Republikës, brenda një kohë shumë të shkurtër dhe në përputhje të plotë me kërkesat e Kushtetutës, ligjit dhe nevojës që ka vendi për një Gjykatë Kushtetuese funksionale.

Konkretisht, zoti Besnik Muçi u emërua pa vonesë nga Presidenti i Republikës në datë 15.10.2019 dhe ceremonia e betimit u zhvillua në datë 18.10.2019. Zonja Elsa Toska, zgjedhur nga Kuvendi në datë 11.11.2019, zonja Marsida Xhaferllari emëruar nga Presidenti në datë 13.11.2019, dhe Zonja Fiona Papajorgji zgjedhur nga Kuvendi në datë 11.11.2019, janë thirrur për betim nga Presidenti i Republikës dhe kanë realizuar betimin në datë 14.11.2019. Përgjatë procedurës së betimit të secilit prej anëtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese, kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, si ata në detyrë, ashtu dhe anëtarët e rinj të emëruar që filluan ushtrimin e detyrës pas bërjes së betimit.

Pra, arsyetimi i përdorur në mbështetje të nismës nga deputetët e mazhorancës, nuk qëndron.

Siç do të shpjegohet në vijim, paralelisht me paraqitjen e këtij propozimi absurd dhe antikushtetues, përmes kësaj nisme ligjore, mazhoranca synonte t'i jepte zgjidhje qëllimit të kahershëm të saj, rrëmbimit të kompetencave të Presidentit të Republikës, dhe kufizimit të rolit të Kreut të Shtetit në këtë proces, për të cilin kjo mazhorancë tashmë kishte nisur edhe një proces hetimor parlamentar shtesë ndaj vet Presidentit të Republikës.

Sjell në kujtesë se, një ditë përpara depozitimit të këtij propozimi ligjor, Kuvendi i Shqipërisë në datë 5.12.2019, me Vendim nr.140/2019, miratoi si shtesën në objektin e veprimtarisë së Komisionit Hetimor Parlamentar të ngritur për veprimtarinë e Presidentit në ushtrim të kompetencës së tij kushtetuese për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, ashtu dhe shtyrjen e afatit për kohëzgjatjen e veprimtarisë së këtij Komisioni për 4 muaj të tjerë.

Kjo veprimtari e mazhorancës, duke refuzuar bashkëpunimin e kërkuar nga Presidenti i Republikës në procesin e emërimeve të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese¹; duke miratuar një Rezolutë në datë 15 nëntor 2019, për t'i kërkuar Gjykatës Kushtetuese dhe institucioneve të tjera mosnjohjen e dekreteve të Presidentit për emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese; duke zgjeruar objektin dhe afatin e veprimtarisë së Komisionit Hetimor ndaj Presidentit të Republikës (datë 5 dhjetor 2019); duke propozuar një nismë ligjore për shtesa në ligjin e Gjykatës Kushtetuese për ndryshimin e procedurës së betimit tek Presidenti i Republikës dhe dhënien e efektit prapaveprues me synim heqjen e mandatit të anëtarit të emëruar nga Presidenti në Gjykatën Kushtetuese (datë 6 dhjetor 2019); duke miratuar ligjin nr. 14, datë 12 shkurt 2020, për ndryshimin e procedurës së betimit pa prituri opinionin e Komisionit të Venecias që vet Kuvendi kishte kërkuar:

- përbën shkeljen më të rëndë të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve në një shtet të së drejtës;
- përbën tejkalim të kompetencave kushtetuese të Kuvendit në procesin e emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese;
- dëshmon shkelje të parimit të luajalitetit kushtetues;

¹ Presidenti i Republikës, në datat 15.10.2019, 5.11.2019, 7.11.2019 dhe 11.11.2019 ka kërkuar në mënyrë të dokumentuar bashkëpunimin e Kuvendit për të zgjedhur sipas radhës anëtarët e Gjykatës Kushtetuese.

- cenon legjitimitetin e Gjykatës Kushtetuese;
- dëshmon qartë se Kuvendi mono- partiak synon kapjen me çdo kusht të Gjykatës Kushtetuese për të emëruar kandidatë që gëzojnë mbështetjen vetëm të një force politike, duke rrëmbyer kompetencat e Kreut të Shtetit.

Përpara paraqitjes së këtij propozimi antikushtetues dhe të pamoralshëm, përgjatë veprimtarisë së tij gjatë kësaj legjislature, Kuvendi i Shqipërisë ka kryer disa shkelje të rënda kushtetuese në dëm të qytetarëve shqiptarë dhe interesit publik, duke mbështetur dhe/ose duke lejuar shkeljen e parimeve themelore kushtetuese të shtetit të së drejtës, ndarjes dhe balancimit të pushteteve, demokracisë, etj., veprime apo vendime këto që kanë sjellë rëndimin e jetës shoqërore në vend, duke e bërë të pamundur ushtrimin e demokracisë funksionale, respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut; çka ka sjellë dhe largimin masiv të popullësisë në emigrim.

Konkretisht:

- Mazhoranca qeverisëse ka treguar mungesë të vullnetit për të bashkëpunuar dhe dialoguar me opozitën, ndërkohë që përgjatë viteve 2018-2019, ka mbizotëzuar një polarizim i fortë politik;
- Mazhoranca qeverisëse asnjëherë nuk i është përgjigjur pozitivisht thirrjeve të Presidentit të Republikës për dialog dhe bashkëpunim të sinqertë ndërmjet palëve;
- Mazhoranca qeverisëse me veprimet e saj ka treguar dëshirë për të kufizuar rolin e opozitës në parlament;
- Mazhoranca qeverisëse në dhjetor të vitit 2017 zgjodhi në mënyrë të njëanshme dhe pa konsensus Prokurorin e Përgjithshëm të Përkohshëm me **69 vota (nga 84 vota)**, në kundërshtim me nenin 179, pika 13, të Kushtetutës dhe Opinionin e Komisionit të Venecias, që rekomandonte tërheqjen e konsensusit sa më të gjerë mbi këtë emërim;
- Pas emërimit antikushtetues nga mazhoranca të Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm, i cili e ushtroi këtë mandat për dy vjet, është fakt që Prokuroria nuk veproi për zbardhjen e shumë aferave korruptive, ndër to dhe të krimeve zgjedhore të konsumuara në vitet 2016-2017-Dosjet 184 (Bashkia Dibër) dhe 339 (Bashkia Durrës);
- Deklarimet publike të Kryeministrit dhe Kryetarit të Komisionit të Ligjeve në Kuvend, drejtuar anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vitet 2017-2018 sollën bllokimin e veprimtarisë së këtij organi, duke bërë që vendet bosh të krijuara në Gjykatën Kushtetuese të mos plotësoheshin. Kjo nxorri jashtë funksionit Gjykatën Kushtetuese tashmë për më shumë se dy vjet;
- Mazhoranca lejoi dhe nuk kundërshtoi emërimet në kundërshtim me ligjin të disa drejtuesve të institucioneve të reja të drejtësisë, (KLP, KLGJ, ILD), edhe pse për disa prej tyre rekomandimet e ONM ishin negative, ndërkohë që disa prej tyre janë në lidhje të drejtpërdrejta gjaku dhe nepotike me anëtarë të Partisë Socialiste, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, apo kanë qënë pjesë të grupit të ekspertëve të nivelit të lartë në procesin e reformës në sistemin e drejtësisë;

- Mungesa e Gjykatës Kushtetuese funksionale për më shumë se dy vjet dhe zgjedhja e njëanshme antikushtetuese e Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm nxorrën tërësisht jashtë kontrollit kushtetues dhe hetimit penal vendimmarrjet e qeverisë dhe të Kuvendit;
- Prej kohësh tashmë Gjykata e Lartë nuk është funksionale si pasojë e mungesës së kuorumit;
- Mazhoranca nxitoi të kryente pa vonesë zëvendësimin e mandateve të **58 deputetëve** të opozitës të dorëhequr në bllok. Zëvendësimi i këtyre mandateve u bë përmes shkresave administrative të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, pa iu nënshtruar procedurës së dëgjësës publike me secilin prej deputetëve të dorëhequr në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, pa u diskutuar nga Kuvendi në seancën plenare, siç kërkon Kushtetuta, Kodi Zgjedhor dhe Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë;
- Si rezultat i dorëheqjes nga mandatet apo mospranimi të mandatit të 182 deputetëve dhe kandidatëve për deputetë të opozitës sot Kuvendi i Shqipërisë përbëhet vetëm nga 122 deputetë, nga 140 që duhet të jetë numri i deputetëve sipas nenit 64 të Kushtetutës;
- Mazhoranca përmes përfaqësuesve të saj në KQZ, pa pjesëmarrjen e opozitës, pa garë dhe pa konkurrencë, zhvilloi e vetme në datën 30 qershor 2019, zgjedhjet për pushtetin vendor. Data 30 qershor 2019 nuk ekziston ligjërisht si datë zgjedhesh për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, pasi Presidenti i Republikës kishte përcaktuar si datë për zhvillimin e zgjedhjeve datën 13 tetor 2019. Ky dekret nuk u zbatua nga anëtarët e Partisë Socialiste që përbëjnë shumicën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Zhvillimi i këtyre zgjedhjeve pa garë dhe pa alternativa konkurruese, në shkelje të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare, solli gjithashtu që i gjithë sistemi i qeverisjes vendore të humbasë legjitimitetin dhe të jetë në duart e Partisë Socialiste, duke përkeqësuar ndjeshëm demokracinë funksionale dhe qeverisjen në nivel vendor. Aktualisht në Gjykatën Kushtetuese është regjistruar një çështje në lidhje me antikushtetutshmërinë e këtyre zgjedhjeve, çështje kjo që pret shqyrtimin dhe përbën një arsye më shumë për mazhorancën qeverisëse për kapjen politike të kësaj Gjykate;
- Mazhoranca socialiste bllokoi botimin në Fletoren Zyrtare të Dekreteve të Presidentit të Republikës, duke shkelur kështu Kushtetutën dhe ligjet në fuqi;
- Bllokimi i veprimtarisë së KED-së prej mazhorancës qeverisëse pengoi gjithashtu edhe zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për më shumë se 3 (tre) vjet, në shkelje të kërkesave të nenit 179/9 të Kushtetutës, duke e lënë praktikisht sistemin e drejtësisë jashtë hetimit disiplinor dhe kontrollit për një periudhë shumë të gjatë.
- Kuvendi i Shqipërisë, shkeli Kushtetutën dhe ligjin në emërimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në muajin Janar 2020, pasi kandidatura e zgjedhur kishte ushtruar funksione politike sipas ligjit, ndërkohë që ai është në lidhje gjaku (vëllai) i një prej deputeteve të mazhorancës qeverisëse;
- Kuvendi ka humbur tërësisht rolin mbikëqyrës dhe kontrollues ndaj ekzekutivit;
- Kuvendi i Shqipërisë përgjatë kësaj legjislature, përveç paketës së fundit të ligjeve të miratuara në datën 12 shkurt 2020, ku bën pjesë dhe ligji nr. 14/2020, objekt shqyrtimi, ka miratuar një mori ligjesh që bien në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, aktet ndërkombëtare që Shqipëria ka ratifikuar dhe që cenojnë interesin publik dhe atë shtetëror.

Ndër këto ligje mund të përmendim:

- Ligji nr. 91/2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, (pjesë e paketës “antishpifje”);
- Ligji nr. 92/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” (pjesë e paketës “antishpifje”);
- Ligji nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”;
- Ligji nr. 75/2019, “Për rininë”;
- Ligji nr. 53/2019, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 52/2019, “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, shoqërisë “ANK”, sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë “Bardh konstruksion”, sh.p.k., si shoqëria koncesionare, për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot – Balldren”;
- Ligji nr. 51/2019, “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, dhe “Gjikuria”, sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë koncesionare “Rruga Oriku – Llogara”, sh.p.k., për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës “Porti i jahteve – By-Pass Oriku – Dukat (ura e Shën Elizës)”;
- Ligji nr. 50/2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”;
- Ligji nr. 44/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”;
- Ligji nr. 42/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’, të ndryshuar”;
- Ligji nr.38/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 37/2019, “Për disa shtesa në aktin normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, dhe ndryshuar me ligjin nr. 3/2015”;
- Ligji nr. 36/2019, “Për një ndryshim në ligjin nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”;
- Ligji nr. 20/2019, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”;
- Ligji nr. 111/2018, “Për Kadastrën”;
- Ligji nr. 94/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”;
- Ligji nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019” ;

- Ligji nr. 37/2018, datë 20.09.2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”;
- Ligji nr. 39/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”;
- Ligji nr. 98/2017, “Për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”.

Përmes këtyre ligjeve Kuvendi i Shqipërisë ka shkelur hapur Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe ka sjellë pasoja të rënda duke cenuar lirinë e veprimtarisë ekonomike, barazinë para ligjit, të drejtën e pronës private, shfrytëzimit racional të pasurisë publike, mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, apo zhvillimit të qëndrueshëm, duke dëmtuar buxhetin dhe financat e shtetit dhe cenuar direkt të drejtat e qytetarëve dhe për pasojë, interesin publik.

Përmes miratimit të këtyre ligjeve mazhoranca qeverisëse ka përmbysur hierarkinë e normave në Republikën e Shqipërisë; ka cenuar parimin e decentralizimit dhe autonomisë së pushtetit vendor; ka shkelur parimin e trajtimit të barabartë dhe ka stimuluar trajtimin preferencial me ligj; ka dhunuar disa herë parimin e sigurisë juridike dhe shtetit të së drejtës; ka krijuar konflikt institucional kushtetues me institucionet e tjera; ka cenuar të drejtat civile dhe politike të qytetarëve; ka cenuar të drejtën e qytetarëve për t’iu drejtuar një Gjykate të caktuar me ligj; ka cenuar respektimin e jetës private; ka cenuar trashëgiminë kulturore dhe identitetin kombëtar; ka cenuar të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të informimit; apo të drejta të tjera të njohura nga Kushtetuta dhe Aktet Ndërkombëtare që janë pjesë e legjislacionit të brendshëm të detyrueshme për zbatim.

Përmes këtyre ligjeve dhe veprimtarisë së Kuvendit është shkelur hapur dhe në mënyrë të përsëritur edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e së cilës janë të detyrueshme për zbatim si për pjesën e dispozitivit, ashtu dhe për pjesën arsyetuese të tyre².

E gjithë kjo sjellje e mazhorancës e cila tashmë duket se zotëron pothuajse totalisht Kuvendin e Shqipërisë, përfshi edhe ata deputetë që vetëm formalisht i përkasin krahut që konsiderohet si opozitar, ka sjellë një krizë të rëndë dhe shumëplanëshe në vend.

Mazhoranca, e pandalur në tentativat e saj për të uzurpuar çdo pushtet në Republikën e Shqipërisë, ka vijuar aktivitetin e saj për të arritur si “trofe final” edhe kapjen e të gjitha emërimeve të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që për këto shkelje të rënda të kryera me miratimin e ligjeve antikushtetuese, mazhoranca të ketë garancinë se do të qëndrojnë në fuqi në çdo gjykim përpara kësaj gjykate.

² Shiko vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 5, datë 7.02.2001; nr. 14, datë 3.06.2009 dhe nr. 21, datë 29.04.2010.

Kjo u evidentua qartë në veprimtarinë e Kuvendit përgjatë muajve tetor 2019 e në vijim, që synonin vetëm rrëmbimin e kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës, për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Konkretisht:

- **Kuvendi bëri të gjitha përpjekjet e mundshme për ta vendosur Presidentin e Republikës në pamundësi për të ushtruar kompetencat kushtetuese në emërimin e anëtarit të dytë të Gjykatës Kushtetuese që i përket atij për plotësim;**
- **Kuvendi përpos shkresave, kërkesave dhe mesazheve të përsëritura të Presidentit të Republikës për bashkëpunim, nuk tregoi asnjëherë luajalitet kushtetues përgjatë procesit të emërimeve të reja në Gjykatën Kushtetuese;**
- **Kuvendi arriti deri aty sa, në datë 15 nëntor 2019, të miratojë një Rezolutë ku t'i kërkonte Gjykatës Kushtetuese, të mos respektonte Dekretin e Presidentit për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese;**
- **Kuvendi për të marrë në mbrojtje Kryetarin e KED-së, Ardian Dvorani, të kallëzuar penalisht nga Presidenti i Republikës, për disa vepra penale, miratoi një rezolutë, dhe inicioi procedurën parlamentare për zgjerimin e objektit të veprimtarisë së Komisionit Hetimor të ngritur për Presidentin dhe shtyrjen e afatit të tij edhe me 4-muaj të tjerë;**
- **Në këtë veprimtari antikushtetuese dhe kriminale rezultoi e përfshirë dhe ministrja e Drejtësisë, të cilën Presidenti i Republikës, së fundmi në muajin shkurt 2020 e ka kallëzuar penalisht në Prokurori për disa vepra penale, sëbashku me disa zyrtarë të lartë të kësaj ministrie;**
- **Kjo veprimtari u shoqërua me propozimin që tre deputetë të mazhorancës bënë për disa shtesa në ligjin nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, të cilat janë hapi final që faktori qëllimin e Kuvendit për të kontrolluar politikisht të gjitha emërimet e reja në Gjykatën Kushtetuese.**

Në finalizim të të gjithë kësaj veprimtarie antikushtetuese, Kuvendi ka miratuar ligjin me **nr. 14/2020**, i cili përbëhet nga një nen i vetëm, dhe që sipas argumenteve të përdorura në relacionin shoqërues, përcakton një procedurë të posaçme të betimit me shkrim vetëm në raste përjashtimore, kur Presidenti nuk e ushtron kompetencën që i ka dhënë Kushtetuta për të organizuar ceremoninë e betimit.

Shtesa e miratuar në nenin 8 të ligjit bazë, parashikon se:

“Presidenti i Republikës organizon ceremoninë e betimit jo më vonë se 10 ditë nga data e zgjedhjes, emërimit ose shpalljes të emëruar të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Nëse gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk thirret për të bërë betimin, pas përfundimit të këtij afati, ai kryen betimin në formë të shkruar dhe ia dërgon atë Presidentit të Republikës, organit të emërtesës dhe Gjykatës Kushtetuese. Data e ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të betimit me shkrim konsiderohet si data e betimit dhe e fillimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.”.

Neni 2, që ishte në propozimin fillestar të projektligjit është tërhequr përgjatë shqyrtimit të projektligjit në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, me argumentin se është çështje për të cilën do të jepet mendim nga Komisioni i Venecias, ndërkohë që situata është krejtësisht ndryshe dhe do të sqarohet në vijim të këtij arsytimi.

Presidenti i Republikës, pasi vlerësoi përputhshmërinë e ligjit nr. 14/2020 *“Për një shtesë në ligjin nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar”* me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, konstaton se ky ligj është në kundërshtim me nenet **4, pikat 2 e 3**, dhe **129** të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

Për arsyet që do të parashtrihen në vijim, në bindje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ushtrim të së drejtës së parashikuar në pikën 1 të nenit 85 të saj, Presidenti i Republikës ka vendosur që ligji nr. 14/2020 *“Për një shtesë në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar”*, i duhet kthyer Kuvendit për rishqyrtimin e tij, pasi shkel në mënyrë të drejtpërdrejtë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, parimet themelore mbi të cilat është ngritur shteti ynë demokratik, dhe cenon në mënyre flagrante kompetencat e Presidentit të Republikës së Shqipërisë të cilat janë të sanksionuara qartë në Kushtetutë.

I. Ligji nr. 14/2020 *“Për një shtesë në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar”*, bie ndesh me nenin 4, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese mbi hierarkinë e normave dhe autorizimin kushtetues në Republikën e Shqipërisë.

1. Neni 4, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon:

“Neni 4

- 1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.*
- 2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.*
- 3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.”*

1.1 Përcaktimi i nenit të sipërpërmendur thekson se Kushtetuta është ligji më i lartë dhe dispozitat e saj zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Ky është një parim themelor i sanksionuar në nenin 4, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit kur rregulli kushtetues parashikon shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti. Përrjashtimi kushtetues, i parashikuar në këtë dispozitë, nënkupton se norma kushtetuese mund edhe të mos gjejë zbatim drejtpërsëdrejti, kur vet Kushtetuta ngarkon posaçërisht organet shtetërore përkatëse për të nxjerrë ligjet dhe aktet e tjera nënligjore/normative, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve në fusha të ndryshme dhe në përputhje me hierarkinë e normave.

1.2 Pra, Kushtetuta përmban dispozita që rregullojnë zbatimin e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, duke i krijuar aty ku është e nevojshme hapësirë ligjvënësit për të vepruar më shumë ose më pak, me përjashtim të rasteve kur vetë Kushtetuta parashikon ndryshe. Është Kushtetuta e cila autorizon ligjvënësin, që duke respektuar konceptet dhe parimet kushtetuese, të caktojë kufijtë e hapësirës rregulluese nëpërmjet nxjerrjes së normave juridike.

1.3 Në rastin konkret, **neni 129 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, renditet ndër dispozitat Kushtetuese të cilat zbatohen drejtpërdrejtë dhe qëllimi i këtij neni nuk mund të rregullohet, shtohet apo ndryshohet me ligj.**

1.4 Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj është shprehur se: *“Teoria normativiste e së drejtës ka në thelbin e saj idenë se marrëdhëniet midis normave juridike bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlefshme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie, dhe në secilin prej këtyre niveleve, qëndron një normë ose grup normash duke përfshirë edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike. [...] Kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht prej saj, ai detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke i dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Ky detyrim rrjedh nga përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës. Në rastet kur kushtetuta le hapësira me qëllim delegimin e kompetencës ligjvënësit të zakonshëm, atëherë, nuk është e nevojshme referimi tek kjo dispozitë, pra e zbatimit të drejtpërdrejt të saj. Nëse ndodhemi para kësaj situate, është e pritshme që aktet normative që do të dalin për këtë qëllim të respektojnë hierarkinë e akteve normative³.”*

1.5 Për më tepër, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka bërë edhe interpretimin e nenit 4, pika 3, të Kushtetutës dhe ka nënvizuar se *“atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund*

³ Vendimi nr. 3, datë 20.02.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

*ta bëjë ligji*⁴. Ajo ka ritheksuar se, “*për çdo rast, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht prej saj, ai detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Ky detyrim rrjedh nga përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës*”⁵.

Neni 129 i Kushtetutës, është një nga dispozitat Kushtetuese që nuk është ndryshuar në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë. Përmbajtja e kësaj dispozite është e njëjtë dhe e pandryshuar që prej vitit 1998, kur Kushtetuta e Republikës është miratuar me referendum popullor më datë 22.11.1998 dhe ka hyrë në fuqi më datë 28 nëntor 1998.

Kushtetutëbërësi (qytetarët e Republikës së Shqipërisë) përmes nenit 129 të Kushtetutës, nuk ka patur asnjë qëllim që të lërë ndonjë hapësirë për ligjvënësin, për të rregulluar më tej procedurën e betimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, për sa kohë nuk referon në ndonjë hapësirë rregulluese me ligj të veçantë të këtij momenti (procesit të betimit).

Në këto kushte, referuar sa më sipër, rezulton se Kuvendi i Shqipërisë, përveç qëllimeve të pastra politike për të kufizuar rolin e Kreut të Shtetit në këtë proces, me miratimin e ligjit nr. 14/2020, ka shkelur përmbajtjen e dispozitave kushtetuese të sipërcituara dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, sipas vendimeve nr. 3/2006 dhe nr.10/2015.

Kuvendi i Shqipërisë, me miratimin e ligjit nr. 14/2020, ka mënjeluar dispozitat kushtetuese duke i dhënë përparësi ligjit nr. 14/2020 dhe duke përmbysur kështu edhe hierarkinë e normave në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuar në nenin 4, pika 2 të Kushtetutës.

II. Ligji nr. 14/2020 “Për një shtesë në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar”, bie ndesh me përmbajtjen e nenit 129 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

1. Neni 8, pika 1, e ligjit në fuqi nr. 8577/2000, që synohet të shohet, aktualisht ka këtë përmbajtje: “1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës së Shqipërisë”.

Kjo dispozitë aktuale e ligjit nr. 8577/2000, ka të njëjtën përmbajtje me nenin 129 të Kushtetutës ku parashikohet shprehimisht se:

“Neni 129

⁴ Vendimi nr. 10, datë 26.02.2015 i Gjykatës Kushtetuese.

⁵ Vendimi nr. 10, datë 26.02.2015 i Gjykatës Kushtetuese.

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës.”

Ndërkohë, me nenin 1 të ligjit nr. 14/2020 “Për një shtesë në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, parashikohet se:

“Neni 1

Në nenin 8, pika 1, shtohet fjalia e dytë me këtë përmbajtje:

Presidenti i Republikës organizon ceremoninë e betimit jo më vonë se 10 ditë nga data e zgjedhjes, emërimit ose shpalljes të emëruar të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Nëse gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk thirret për të bërë betimin, pas përfundimit të këtij afati, ai kryen betimin në formë të shkruar dhe ia dërgon atë Presidentit të Republikës, organit të emërtesës dhe Gjykatës Kushtetuese. Data e ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të betimit me shkrim konsiderohet si data e betimit dhe e fillimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.”.

1.1 Ky ndryshim, i justifikuar nga propozuesit dhe i miratuar nga Kuvendi si “mekanizëm zhbllokues” cenon drejtpërdrejtë kompetencat e Presidentit të Republikës dhe është në kundërshtim flagrant me nenin 129 të Kushtetutës që përcakton se: “Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin **para** Presidentit të Republikës.”

1.2 Nga vetë propozuesit dhe anëtarët e komisionit përgjegjës për çështjet ligjore, cilësohet se “Neni 129 i Kushtetutës ruan në mënyrë të padiskutueshme epërsinë në bërjen e betimit, dhe rregullimi me ligj mbetet si një rast tërësisht përjashtimor.”

Pra vetë propozuesit e kësaj norme dhe më pas të gjithë deputetët miratues të kësaj nisme, janë të ndërgjegjshëm për epërsinë e normës kushtetuese që përcakton të detyrueshme që betimi të bëhet para Presidentit të Republikës dhe askund tjetër. Vetë propozuesit dhe miratuesit e ligjit nr. 14/2020, janë të qartë dhe pranojnë **antikushtetutshmërinë e propozimit dhe rrjedhimisht dhe të ligjit nr. 14/2020 të miratuar**, por e justifikojnë atë me të qënurit si një mekanizëm që do të “zbatohet përjashtimisht”.

Ky nivel papërgjegjshmërie dhe antikushtetutshmërie në procesin parlamentar nuk është gjë tjetër vetëm një iniciativë politike e strukturuar qëllimisht për të kufizuar rolin dhe kompetencat kushtetuese të Kreut të Shtetit. Nëse mazhoranca ka këtë qëllim, ajo mund ta realizojë përmes ndryshimeve kushtetuese, por kurrsesi në këtë formë, të cilën edhe vet e pranon se është antikushtetuese.

2. Neni 129 i Kushtetutës, është një ndër nenet e pakta të Kushtetutës sonë që përbëhet vetëm nga një fjali dhe që nuk ka ndryshuar që prej miratimit të saj me referendum popullor në vitin 1998. Kjo dispozitë kushtetuese që flet posaçërisht për betimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, **e ka**

konsideruar kaq të veçantë e të rëndësishëm këtë moment për të legjitimuar fillimin e ushtrimit të detyrës për gjyqtarin kushtetues, sa është vlerësuar nga kushtetutbërësi të vihet në një dispozitë më vete.

3. Procesi i betimit para Presidentit të Republikës, është kërkesë kushtetuese për të zyrtarizuar marrjen e detyrës dhe përgjegjësiqve që i njeh detyra e re të sapozgjedhurit. Neni 129 i Kushtetutës, nuk kërkon vetëm elementin formal të bërjes së betimit dhe depozitimit para Presidentit, por përmban në vetvete detyrimin e anëtarit të zgjedhur/emëruar të Gjykatës Kushtetuese që:

- a) të jetë i pranishëm personalisht dhe fizikisht para Presidentit të Republikës; shoqëruar me
- b) zhvillimin e ceremonisë/procedurës përkatëse para Presidentit të Republikës duke kryer deklarin e betimit dhe nënshkrimin e tij, për të ndjerë personi që betohet, përgjegjshmërinë e funksionit që i është dhënë.

3.1 Jo më kot betimi për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese është vlerësuar nga Kushtetutbërësi që të bëhet para Presidentit të Republikës, i cili është Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson Unitetin e Popullit. Si i tillë, edhe gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, që do të jetë gjithashtu gardian i Kushtetutës, ceremoninë e betimit në tërësinë e saj, duhet ta bëjë pikërisht para Presidentit të Republikës, dhe para tij, duhet të betohet se: **“Gjatë kryerjes së detyrave ai/ajo do t’i qëndrojë kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë!”**

3.2 Kjo nuk është një kërkesë kushtetuese e rastësishme, por i përgjigjet si traditës sonë kombëtare, ashtu sa dhe reflekton një traditë të gjatë historike ndërkombëtare, që është kujdesur deri në detajet më të vogla simbolike të këtij procesi kaq të rëndësishëm, për personin që duhet të vijojë punën në shërbim të shtetasve, në mbrojtje të parimeve dhe të drejtave themelore kushtetuese.

3.3 Ky veprim është **shenjë besnikërie ndaj Kushtetutës së vendit**. Aq i rëndësishëm është ky moment për personin që nis zyrtarisht detyrën pas procesit të betimit, sa protokollat e vendeve të tjera (përfshirë **Shtetet e Bashkuara të Amerikës**), kërkojnë dhe lejojnë që në një moment të tillë të jenë të pranishëm dhe familjarët e personit, **për të kuptuar edhe ata rëndësinë e detyrës që merr përsipër të kryejë i afërmi i tyre.**

4. Kushtetuta ka parashikuar betimin, si element të domosdoshëm para fillimit të detyrës, për gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, për Presidentin e Republikës, për deputetin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, dhe për Kryeministrin, zëvendëskryeministrin dhe ministrat.

4.1 Neni 72, i Kushtetutës përcakton se deputetët, para fillimit të ushtrimit të mandatit, *bëjnë betimin në Kuvend*. Mandati i deputetit mbaron ose është i pavlefshëm, nëse nuk ka bërë betimin. Pra në këtë rast, Kushtetuta ka vlerësuar të përcaktojë **vendin** (në Kuvend) dhe **momentin** e kryerjes së betimit (para fillimit të ushtrimit të mandatit).

4.2 Neni 88, i Kushtetutës përcakton se, *Presidenti fillon në detyrë pasi bën betimin para Kuvendit*. Edhe në këtë rast, Kushtetuta ka përcaktur **vendin** e bërjes së betimit (para Kuvendit), **momentin** (para fillimit në detyrë), duke shtuar dhe **saktësimin e formulës** së betimit për Presidentin e Republikës.

4.3 Neni 99, i Kushtetutës, përcakton se: *Para fillimit të detyrës, Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat betohen para Presidentit të Republikës*. Sërisht Kushtetuta ka përcaktuar **vendin** e kryerjes së betimit (para Presidentit të Republikës) dhe **momentin** e kryerjes së betimit (para fillimit të detyrës).

4.4 Në të treja rastet më sipër, përcaktimi i momentit të kryerjes së betimit, është kthyer në një kusht thelbësor, kushtetues, për të nisur ushtrimin e detyrës. Në asnjë prej këtyre rasteve, **momenti** nuk është i përkufizuar me kufij të saktë kohor se brenda sa ditëve apo orëve duhet të kryhet betimi. Nuk ka asnjë ligj që të kryejë një përcaktim të tillë, as për Presidentin, që është Kreu i Shtetit, as për deputetët, as për Kryeministrin, zëvendëskryeministrin apo ministrat. **Kushtetuta nuk e kërkon, as nuk e autorizon një detajim të tillë, ashtu siç nuk e ka kërkuar e as më pak autorizuar për kryerjen e betimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.**

4.5 Miratimi i ndryshimeve në ligjin nr. 8577/2000, kamufluar si propozim i tre deputetëve, por që sipas Relacionit shoqërues të të cilit dallohet qartë angazhimi qeveritar për finalizimin e saj, lidhet ngushtësisht dhe pandashmërisht me nevojën antikushtetuese të mazhorancës për **shmangien e betimit para Presidentit të Republikës, si Institucioni i vetëm i pa kapur në mbrojtje të të drejtave dhe lirive kushtetuese të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.**

4.6 Këtë e tregojnë jo vetëm veprimet e koordinuara të Kuvendit dhe të Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në plotësimin e vakancave të Gjykatës Kushtetuese në muajin nëntor 2019, veprime që janë denoncuar publikisht dhe në organet ligjzbatuese; por edhe vetë **nguti për të sajuar një mekanizëm antikueshtetues** përmes ndryshimit të ligjit sipas orekseve të mazhorancës që përveç Qeverisë, drejton e vetme Kuvendin, pushtetin vendor dhe shumicën e institucioneve të pavarura.

5. Nguti për ta miratuar këtë ndryshim pa konsultim, pa reflektim mbi mendimet e marra, pa pritur Opinionin nga Komisioni i Venecias të kërkuar po nga Kuvendi në datë 30 dhjetor 2019, duke përdorur ndryshimin ligjor, si mjetin më të lehtë dhe komod në arritjen e qëllimit për kapjen e Gjykatës Kushtetuese, kur sot Shqipëria ka një Kuvend monopartiak, reflektohet edhe në Relacionin shoqërues të propozimit të nismës.

5.1 Nisma e 3 deputetëve, si çdo nismë ligjore, shoqërohet me Relacionin shoqërues. Po të lexohet Relacioni që mban firmën e 3 deputetëve nismëtarë, vërehet qartë që në fakt kjo është një nismë

qeveritare, që siç është vërtetuar nga komunikimet institucionale, është hezitur t'i nënshtrohet procesit të konsultimit.

5.2 Relacioni shoqërues ka të njëjtin format si relacionet e projektakteve që propozohen nga Këshilli i Ministrave. Çfarë duhet të përmbajë një relacion shoqërues, përcaktohet në Vendimin nr. 584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar.

Por kjo përmbajtje dhe ky format është i detyrueshëm vetëm për propozimet e Këshillit të Ministrave. Ndërkohë, edhe sikur për lehtësi të jetë marrë si model ky relacion nga 3 deputetët, në Kreun II të relacionit citohet:

“Projektligji nuk është përfshirë në programin analitik të akteve, por është në përputhje me objektivat madhorë të qeverisë shqiptare, për të vijuar me reformimin e sistemit të drejtësisë dhe krijimin sa më parë të Gjykatës Kushtetuese.”

5.3 Në një nismë të tre deputetëve që investojnë Kuvendin me dëshirën e mirë për të adresuar përmes ndryshimeve ligjore një situatë që ata e vlerësojnë shqetësuese, **kurrsesi nuk mund të referohet dhe të adresohet në të**, shqetësimi i Këshillit të Ministrave dhe angazhimet e këtij të fundit përmes programit analitik të akteve që synojnë të përmbushin objektivat madhorë vetëm të qeverisë, jo të Kuvendit! Deputetët përfaqësojnë sovranin që i ka votuar, jo Këshillin e Ministrave!

Deputetët nuk mund të referojnë dhe argumentojnë nisma ligjore sipas programit analitik të akteve të Këshillit të Ministrave, duke u angazhuar dhe në mënyrë proaktive përmes nënshkrimit të tyre.

5.4 Fakti që tre deputetët nismëtarë janë nisur në bërjen e këtij propozimi, pikërisht nga shqetësimi i objektivave qeveritare, siç posaçërisht e përcaktojnë në relacionin që e kanë nënshkruar po vetë, është **tregues me rëndësi i shmangies së procedurave normale të hartimit dhe propozimit të ndryshimeve ligjore, me qëllim përpshpejtimin e skenarit për të kapur sistemin e Drejtësisë dhe veçanërisht, Gjykatën Kushtetuese.**

5.5 Ky skenar doli më tepër në dritë së fundmi përmes veprimeve aktive dhe të kundraligjshme të ministrit të Drejtësisë për të ndërhyrë në procesin e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, fakte dhe rrethana këto për të cilat Presidenti i Republikës ka paraqitur në Prokurorinë e Posaçme kallëzim penal. Pra edhe me këtë nismë ligjore duket qartë “objektivi madhor” i qeverisë që vijimin e reformës në sistemin e drejtësisë e barazon me ndërhyrje të drejtpërdrejtë të qeverisë në procesin e emërimit dhe ushtrimin të detyrës të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim që Presidentit të Republikës, t'i rrëmbehen kompetencat kushtetuese në këtë proces, si ato të emërimit, tashmë edhe të kryerjes së betimit.

6. Gjendet me vend të ritheksohet edhe një herë se, kuptimi normativist bazohet në hierarkinë juridike dhe në supremacinë e normës kushtetuese ndaj akteve më të ulta, që në doktrinën kushtetuese njihet si parimi i epërsisë (*supremacisë*) së Kushtetutës. Kushtetuta, si ligji themelor i shtetit, detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese, që përbën një parim tjetër të rëndësishëm, atë të kushtetutshmërisë funksionale. Mbështetur në këto parime, veprimtaria dhe funksionet e të gjitha organeve shtetërore bazohen në Kushtetutë. Janë veprimtaria normëvënëse e organeve të autorizuara nga Kushtetuta si edhe natyra e përmbajtja e ligjeve dhe akteve nënligjore që ato nxjerrin, të cilat përcaktojnë edhe pozitën e këtyre akteve në hierarkinë e normave juridike. Nga kjo, buron kërkesa dhe parimi, sipas të cilit, aktet juridike më të ulta duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material⁶.

6.1 Ndërsa ndryshimet e propozuara dhe të miratuara në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, nuk kanë asnjë autorizim nga Kushtetuta për **përcaktimin e procedurës se si organizohet ceremonia e betimit, dhe aq më pak të parashikojnë alternativa të formës së betimit**, që justifikohet si nismë nën nevojën e një **“mekanizmi zhbllokues” të pakërkuar nga nevojat dhe të pambështetur në delegimin e shprehur të ndonjë dispozite të Kushtetutës.**

6.2 Ndryshimet e propozuara në ligjin nr. 8577/2000, shkelin nenin 129 të Kushtetutës, **ndërkohë që Kushtetuta nuk ka ngarkuar posaçërisht organet shtetërore përkatëse për të nxjerrë ligje dhe akte të tjera nënligjore për këtë çështje, duke shkelur kështu hierarkinë e normave.**

6.3 Përmes këtij parashikimi, **ligjvënësi i ka krijuar vetë hapësira vetes për të vepruar më shumë se çfarë e lejon Kushtetuta**, që sa i përket betimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, nuk ka patur nevojë të përcaktojë kufij të hapësirës rregulluese mbi mënyrën e kryerjes së aktit të betimit, pasi zbatohet direkt neni 129 i saj. Kjo bazuar dhe nga mënyra e formulimit të këtij neni, pa lënë asgjë mbi këtë proces në diskrecion të ligjvënësit.

III. Mbi sjelljen e pahijshme dhe fyese të Kuvendit të Shqipërisë përkundrejt kërkesës në Komisionin e Venecias dhe vizitës së delegacionit të këtij komisioni në Tiranë

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, më 30 dhjetor 2019, i kërkoi Komisionit të Venecias një Opinion mbi procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë.

⁶ Vendimi nr. 29, datë 9.11.2005 i Gjykatës Kushtetuese.

1.1 Kuvendi, në shkresën me nr. prot. 4531, datë 30.12.2019, pyeti posaçërisht Komisionin e Venecias për 6 pyetje, ku shumica e këtyre pyetjeve kishin të bënin pikërisht me procesin e betimit. Konkretisht, Kuvendi kërkoi nga Komisioni i Venecias dhënien e opinionit për këto pyetje:

- A mundet Presidenti të mos organizojë ceremoninë e betimit të gjyqtarit kushtetues, kur ai/ajo në kuptim të ligjit konsiderohen të emëruar?
- Në rast se Presidenti nuk organizon ceremoninë e betimit të gjyqtarit kushtetues, nisur nga solemniteti i betimit si akt, çfarë mekanizmi mund të përdoret për ta zhbllokuar një situatë të tillë?
- A është betimi me shkrim një formë për të plotësuar kushtin e betimit, për të filluar ushtrimin e detyrës, në situatën kur gjyqtari është emëruar në detyrë për efekt të ligjit?
- Cilat mund të ishin zgjidhjet sipas standardeve më të mira ndërkombëtare për të shmangur rastet kur organi i ngarkuar me kryerjen e betimit refuzon të thërrasë për betim zyrtarin?

1.2 Delegacioni i ekspertëve të Komisionit të Venecias kishte planifikuar realizimin e një vizite faktmbledhëse për t'u realizuar ndërmjet datave 12-14 shkurt 2020. E ndërsa delegacioni i Komisionit të Venecias, në datën 12.2.2020, mbërriti në Tiranë për të nisur takimet me qëllim përgatitjen e Opinionit mbi kërkesat e Kuvendit (por edhe të Presidentit të Republikës), Kuvendi në mënyrën më të papërgjegjshme, të pabesë dhe të pamoralshme, po në datën 12.02.2020, në orët e vona të pasdites, miratoi këtë ligj antikushtetues me nr. 14/2020 "*Për një shtesë në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar*", duke i dhënë vet përgjigje pyetjeve për të cilat kishte thirrur Komisionin e Venecias në Tiranë.

1.3 Pavarësisht veprimeve taktiko-politike për të tëhequr në momentin e fundit një nen të projektligjit (nenin 2 të projektligjit fillestar të depozituar që përmbante efektin prapaveprues edhe përsa kishte ndodhur), Kuvendi nuk nguroi ta miratonte këtë ligj, edhe pse ai shkel drejtpërdrejt nenin 129 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, **apo edhe pse Komisioni i Venecias kishte mbërritur në Tiranë dhe kishte filluar organizimin e takimeve për të shprehur Opinionin e tij të kërkuar nga vetë Kuvendi.**

1.4 Ky veprim i mazhorancës, për të mos pritur Komisionin e Venecias për një mendim mbi këtë çështje, është një fyerje shumë e rëndë që i bëhet organizmave të Këshillit të Europës në tërësi, Komisionit të Venecias në veçanti, si dhe Ambasadave dhe Ambasadorëve që mbështetën nismën e mazhorancës, për të kërkuar thirrjen e Komisionit të Venecias për këtë çështje. Me këtë veprim, mazhoranca ka zhvleftësuar tërësisht vizitën e ekspertëve të Komisionit të Venecias, duke delegitimuar rëndësinë e këtij Komisioni.

IV. Mbi mungesën e konsultimit të nismës, mungesën e transparencës dhe arbitraritetin e Kuvendit në miratimin e ligjit

1. Në Raportin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, i publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit⁷, në seksionin III “Konsultimi Publik i Projektligjit”, relatohet ndër të tjera fakti se, **edhe kjo nismë së bashku me ndryshimet për ligjin nr. 96/2016, është përcjellë për mendim** pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Shkollës së Magjistraturës, shoqatës së gjyqtarëve, Fakultetit të Drejtësisë, UT, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Fondacionit SOROS, Res Publica, Institutit të Studimeve Politike dhe Ministrisë së Drejtësisë.

2. I shqetësuar për procesin e konsultimit që kishte shoqëruar një nismë të tillë antikushtetuese, që ishte parashikuar për shqyrtim në Seancën Plenare të datës 12.02.2020, ora 10:00, Presidenti i Republikës, kërkoi informacion zyrtar nga aktorët e cituar në këtë Raport, mbi konsultimin dhe mendimet e dhëna. Konkretisht:

- Me shkresën me nr. prot. 642, datë 11.02.2020, të Institucionit të Presidentit të Republikës, u kërkua informacion nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.
- Me shkresën me nr. prot. 642/1, datë 11.02.2020, të Institucionit të Presidentit të Republikës, u kërkua informacion nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Shkolla e Magjistraturës.
- Me shkresën me nr. prot. 642/2, datë 11.02.2020, të Institucionit të Presidentit të Republikës, u kërkua informacion nga misioni Euralius V.
- Me shkresën me nr. prot. 642/3, datë 11.02.2020, të Institucionit të Presidentit të Republikës, u kërkua informacion nga Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë; Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës; Komiteti Shqiptar i Helsinkit; Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë; Qendra Res Publica; Instituti i Studimeve Politike.

3. Nga këta aktorë, u administruan këto përgjigje zyrtare në Institucionin e Presidentit të Republikës:

3.1 Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. prot. 1128, datë 19.02.2020, protokolluar pranë Institucionit të Presidentit me nr. prot. 779, datë 20.02.2020. Ky Fondacion është shprehur se “*Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë për shkak të pamundësisë për t`ju përgjigjur në afatin e caktuar nuk ka dërguar mendime për këto dy projektligje.*”

⁷Raporti gjendet i publikuar në link-un:

<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200210151114Raporti%20Gjykata%20Kushtetuese.pdf>.

3.2 Shkolla e Magjistraturës ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. prot. 121/1, datë 14.02.2020, protokolluar pranë Institucionit të Presidentit me nr. prot. 642/6, datë 17.02.2020, duke informuar se: ***“Shkolla e Magjistraturës nuk e ka vlerësuar të shfaqë opinionin ligjor për projektligjin e sipërcituar.”***

3.3 Qendra Res Publica, me shkresën e datës 13.02.2020, protokolluar pranë Institucionit të Presidentit me nr. prot. 642/7, datë 17.02.2020, ka informuar se “[...] ***qendra Res Publica nuk i ka kthyer asnjë përgjigje për shkak të ngarkesës së madhe të punës në këtë periudhë. Për rrjedhojë, pavarësisht ftesës, nuk kemi marrë pjesë në konsultim dhe as kemi dërguar ndonjë opinion lidhur me draftin”***.”

3.4 Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. prot. 48/1, datë 12.02.2020, protokolluar pranë Institucionit të Presidentit me nr. prot. 642/4, datë 13.02.2020, me anë të së cilës ka informuar se: “[...] ***informojmë se nuk ka pasur kërkesë nga ana e Kuvendit drejtuar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për të dhënë mendime mbi nismën ligjvënëse të sipërcituar. Për rrjedhojë, lidhur me këtë nismë ligjore, nuk ka ndonjë mendim të konsultuar dhe të shqyrtuar nga anëtarët e Këshillit ose mbledhja e tij apo të përcjellë Kuvendit nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Nisur nga ardhja në dijeni, përmes shkresës Tuaj, të kësaj rrethane në përmbajtjen e Raportit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, është kontaktuar menjëherë ky Komision për të marrë masat që, në lidhje me këtë aspekt, të sqarohet publikisht apo të korrigohet dokumenti parlamentar (Raporti) i kësaj nisme ligjore.”***

3.5 Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën me nr. prot. 1095/1, datë 21.02.2020, protokolluar pranë Institucionit të Presidentit me nr. prot. 979, datë 26.02.2020, ka informuar se: ***“Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk i është kërkuar dhënie e një opinion në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa në Ligjin nr. 8577, datë 10.02.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar”, ndaj dhe nuk ka dhënë mendim dhe as opinion, me shkrim ose verbal, pranë institucioneve të tjera.”***

3.6 Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me shkresën me nr. prot. 270/1, datë 26.02.2020, protokolluar pranë Institucionit të Presidentit me nr. prot. 979/1, datë 26.02.2020, ka informuar se: “[...] ***Këshilli i Lartë i Prokurorisë është përfshirë dhe ka marrë pjesë në takimet e Grupit të Punës, për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” [...] Ndërsa, për projektligjin “Për disa shtesa në Ligjin nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, nuk rezulton të jetë kërkuar mendim nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.”***

3.7 Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. prot. 40, datë 17.02.2020, duke vënë në dispozicion shkresën me nr. prot. 16, datë 01.02.2020 drejtuar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ku ka parashtruar **kundërshtimet dhe opionencën e fortë, bazuar mbi argumente ligjore dhe kushtetuese ndaj kësaj nisme.** Komiteti Shqiptar i Helsinkit në opinionin e dhënë për Kuvendin ka vlerësuar se:

“Ceremonia e betimit që zhvillohet pranë Presidentit nuk mund të realizohet në formë të shkruar, pasi betimi në vetvete, si një akt i lartë solemniteti që parashikohet në Kushtetutë, që kërkon prezencën fizike të personit që betohet se do të respektojë Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, para Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, sikurse dihet atributet që Kushtetuta i ka caktuar një organi, nuk mund t`i jepen një organi tjetër. Ndaj akti i betimit duhet të bëhet vetëm para këtij institucioni. Forma shkresore që parashikohet me ndryshimet e propozuara, në vlerësimin tonë, përveç se nuk është tipike për aktet ceremoniale të betimit të realizuara me funksionarët e nivelit të lartë në këto 2-3 dekadat e fundit, shmang një kompetencë ekskluzive që Kushtetuta ja ka akorduar Presidentit të RSH. [...] Gjithashtu, duhet të kemi parasysh që Presidenti i Republikës mund të refuzojë të organizojë ceremoninë e betimit sepse ai konsideron zgjedhjen ose emërimin e tij jo në përputhje me Kushtetutën (ose për shkaqe të tjera)⁸.

3.8 Instituti i Studimeve Politike, me shkresën me nr. prot. 84/1, datë 13.02.2020, protokolluar pranë Institucionit të Presidentit me nr. prot. 642/5, datë 14.02.2020, ka informuar se: *“[...] Instituti i Studimeve Politike është ftuar përmes komunikimit elektronik për të dhënë opinionin e vet, opinion të cilin e ka adresuar zyrtarisht në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. ISP nuk është ftuar për të qënë i pranishëm në seancën dëgjimore dhe nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Kuvendi lidhur me opinionin tonë. Për këtë arsye më datë 3.02.2020 ne kemi vendosur ta bëjmë publike opinionin tonë përmes publikimit në faqen zyrtare të ISP”.*

3.9 Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se, misioni i ekspertizës së Bashkimit Evropian Euralius V, nuk i ka kthyer përgjigje letrës së dërguar prej Presidentit të Republikës, edhe përse pas dërgimit të shkresës zyrtare, me këtë mision Institucioni i Presidentit të Republikës ka komunikuar si në rrugë elektronike, ashtu edhe telefonike, për ta rikutjuar mbi rëndësinë e kthimit të një përgjigjeje. Ky fakt vë në pikëpyetje serioze konsultimin e pretenduar si të zhvilluar me ekspertët e misionit Euralius V.

4. Pra, sa më sipër, sipas komunikimeve zyrtare me Presidentin e Republikës, këta aktorë (përveç misionit Euralius që nuk ka përcjellë ende ndonjë qëndrim zyrtar depozituar në Kuvend mbi këtë nismë) kanë deklaruar se, **nuk kanë dhënë asnjë mendim apo janë shprehur kundër kësaj nisme ligjore.**

⁸ Shiko letrën nr.16, datë 1 shkurt 2020 që KSHH i ka drejtuar Komisionit për Çështjet Ligjore në Kuvend.

4.1 Si Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ashtu dhe Instituti i Studimeve Politike, kanë vënë theksin tek fenomeni që po shfaqet kaq shpesh kohët e fundit, ai i ndërhyrjeve në ligje, veçanërisht në ato organike, për adresimin e situatave specifike, që shfaqen rast pas rasti.

Pikërisht për këto çështje, misioni Euralius ka asistuar autoritetet shqiptare duke lënë një trashëgimi të shkëlqyer edukative të vlefshme për institucionet shqiptare. Ekspertiza e tyre e standarteve Evropiane na ka orientuar se ligji duhet të gëzojë qëndrueshmëri dhe të adresojë rregullim objektiv të rrethanave të përcaktuara shoqërore, duke ju referuar karakteristikave të tyre të identifikueshme, dhe jo të ndryshohen sipas dëshirave të subjekteve të caktuar. Vetë misioni Euralius, përmes asistencës së tij teknike dhe me integritet në vitin 2010, ka lënë pas një dokument që ka orientuar për vite me rradhë procesin e hartimit të ligjeve, duke këshilluar se:

“Çdo projekt për hartimin e një ligji duhet të paraprihet nga vlerësimi dhe vërtetimi i arsyeve pse ligji nevojitet, në veçanti justifikimi i tij politik dhe ligjor. [...] Ata të cilët do të përgatisin ligjin duhet të përcaktojnë se në çfarë mase dhe në cilin drejtim ligji i ri do të kërkojë të ndryshojë skemën ekzistuese legislative, cilat do të jenë pasojat e ligjit të ri për interesa të ndryshme që preken dhe cilat do të jenë kostot e ligjit të ri [...] Ndryshimi i shpeshtë i ligjeve duhet realizuar me kujdes. Kjo praktikë mund të ulë sigurinë e zbatimit të ligjit, dhe mund të krijojë dyshime mbi stabilitetin e ligjit dhe të lëkundë besimin në të.”⁹.

Këto parime nuk janë mbajtur në konsideratë në rastin konkret, kur ndërmerret nisma për të amenduar një nen të vetëm të ligjit, si nismë e tre deputetëve, në shkelje të Kushtetutës dhe në zbatim të urdhërimeve sipas skenarëve të paracaktuar nga mazhoranca parlamentare qeverisëse.

Veçanërisht kur po të njëjtët deputetë propozues, kanë votuar Rezolutën në nëntor 2019, ku i japin mbështetje dhe legjitimitet aktit të betimit personal të kandidatës për anëtare të Gjykatës Kushtetuese, kemi të bëjmë me një nismë ligjore në konflikt interesi, post factum dhe si e tillë, me mungesë thelbësore argumenti¹⁰.

4.2 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ashtu dhe Instituti i Studimeve Politike, kanë vënë theksin në aktin e betimit si një akt jo thjesht formal, por parakusht për nisjen e mandatit, për të drejta e përgjegjësi kushtetuese që burojnë nga ky moment dhe deformim thelbësor të institutit të betimit nga nisma ligjore.

⁹ Manual i hartimit të ligjeve- Një udhërrëfyes për procesin legjislativ në Shqipëri, 2010, Botim i përgatitur nën përgjegjësinë e Misionit EURALIUS (Misioni European i Asistencës për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë).

¹⁰ Opinion i Institutit të Studimeve Politike, drejtuar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, me shkresën me nr. prot. 78, datë 23.01.2020.

4.3 Instituti i Studimeve Politke, krijimin e një institucioni të tillë paralel dhe formal betimi e ka cilësuar se: *“deformon solemnitetin dhe legjitimitetin e individëve të zgjedhur, dobëson ndjeshëm institucionin e Presidentit, institucionin e Kuvendit dhe çdo institucion tjetër emërtese, si dhe hap mundësi të reja abuzive për kriza të tjera për këtë çështje në të ardhmen”*¹¹.

Instituti i Studimeve Politike, në opinionin e dhënë ndër të tjera, ka cituar se: *“Përderisa Kuvendi ka konsumuar mjetet institucionale dhe pret Opinionin e Komisionit të Venecias, dhe përderisa Kuvendi ka tashmë një Komision hetimor ndaj akteve të Presidentit [...], ne vlerësojmë se çdo ndërhyrje për të ndrydhur praktikën për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, nuk janë ndihmuese për zgjidhjen e krizës, por e kalojnë atë në konflikt institucional në një nivel tjetër.*

[...] Kjo nismë ligjore as nuk përputhet me përmbajtjen e draftit, situatën politike në vend, me raportin e Kuvendit me Komisionin e Venecias, me Gjykatën Kushtetuese dhe me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Përmes krijimit të një institucioni të ri të betimit “betimi në formë të shkruar dhe ia dërgon Presidentit, organit të emërtesës”, rrezikon të deformojë parimet dhe normat kushtetuese dhe të krijojë precedent të pa aplikueshëm në asnjë vend evropian”.

4.4 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në opinionin dërguar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, me shkresën me nr. prot. 16, datë 1.02.2020, është shprehur për këtë nismë se:

“Lidhur me këtë propozim, KSHH vlerëson se ceremonia e betimit që zhvillohet pranë Presidentit nuk mund të realizohet në formë të shkruar, pasi betimi në vetvete, si një akt i lartë solemniteti që parashikohet në Kushtetutë, që kërkon prezencën fizike të personit që betohet se do të respektojë Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, para Presidentit të RSH. Gjithashtu, sikurse dihet atributet që Kushtetuta i ka caktuar një organi, nuk mund t'i jepen një organi tjetër. Ndaj akti i betimit duhet të bëhet vetëm para këtij institucioni. Forma shkresore që parashikohet me ndryshimet e propozuara, në vlerësimin tonë, përveç se nuk është tipike për aktet ceremoniale të betimit të realizuara me funksionarët e nivelit të lartë në këto 2-3 dekadat e fundit, shmang një kompetencë ekskluzive që Kushtetuta ja ka akorduar Presidentit të RSH. Kushtetuta e vendit tonë e parashikon aktin e betimit për një sërë funksionarësh të lartë publikë, në të tria degët e pushteteve. Madje akti i betimit parashikohet edhe për vetë Presidentin e RSH, i cili para se të fillojë detyrën duhet të bëjë betimin para Kuvendit. Pra akti i betimit para institucionit të parashikuar në Kushtetutë merr një rëndësi të veçantë dhe Kushtetuta e konsideron këtë akt si një kusht për fillimin e detyrës. Në këtë kontekst, akti i betimit nuk mund të jetë

¹¹ Opinion i Institutit të Studimeve Politike, drejtuar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, me shkresën me nr. prot. 78, datë 23.01.2020.

krejtësisht formal. Gjithashtu, duhet të kemi në konsideratë që Presidenti i Republikës mund të refuzojë të organizojë ceremoninë e betimit sepse ai konsideron zgjedhjen ose emërimin e tij jo në përputhje me Kushtetutën (ose për shkaqe të tjera).

KSHH thekson nevojën se ndryshimet në kuadrin ligjor në fuqi kërkojnë analizë të thellë, objektive dhe profesionale dhe duhet të marrin në konsideratë efektet që ato krijojnë në periudhë afatgjatë. Këto ndryshime nuk duhet të marrin në konsideratë raste të shkëputura dhe sporadike dhe aq më tepër konfliktet që krijohen midis institucioneve kushtetuese, të cilat mund të zgjidhen në rrugë të tjera si psh duke vendosur në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Vetë Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka theksuar rolin e rëndësishëm të Presidentit të RSH, si atë të arbitrit, të moderatorit të pushteteve e të rregullatorit, si një figure neutrale, me një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e krizave, në balancimin e pushteteve, si dhe në kryerjen e funksioneve të tyre respektive.”

Komentet dhe opinionet e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe Institutit të Studimeve Politike, duhet të lexohen me vëmendje nga deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, sidomos prej atyre që kanë vullnet për të përmirësuar dijet e tyre në fushën e së drejtës kushtetuese.

Sa më sipër, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Raportin që i ka servitur publikut dhe Seancës Plenare, ku citon se:

“Pas depozitimit dhe përfshirjes së dy nismave ligjore “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe “Për disa shtesa në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, në Kalendarin e Punës së Komisionit për Çështjet Ligjore, këto nisma i janë përcjellë për mendim Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Shkollës së Magjistraturës, shoqatës së gjyqtarëve, Fakultetit të Drejtësisë, UT, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Fondacionit SOROS, Res Publica, Institutit të Studimeve Politike dhe Ministrisë së Drejtësisë.”;

ka përcjellë për publikun dhe për seancën plenare një informacion të rremë, duke përdorur si mekanizëm mbrojtës përmendjen në Raportin e tij për këtë projektligj, dy nisma ligjore.

5. Kjo manovër është kryer për të krijuar imazhin dhe përshtypjen e gënjeshtërt në publik se, edhe projektligji për ndryshime në Ligjin nr.8577/2000 “Për Gjykatën Kushtetuese” është konsultuar duke marrë mendimin e institucioneve të përmendura më sipër.

5.1 Pra është synuar të krijohet imazhi dhe përshtypja se ky projektligj është konsultuar dhe i është marrë mendimi institucioneve si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, institucione këto që kanë konfirmuar shkresërisht para Presidentit të Republikës, se nuk u është kërkuar dhe nuk kanë dhënë

mendim për këtë akt. Në të njëjtin pozicion janë edhe “Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” dhe “Qendra Res-Publica”, të cilat kanë konfirmuar se nuk kanë dhënë mendim për këtë nismë ligjore.

5.2 Ndërkohë që edhe ato organizata që janë shprehur, kanë dhënë mendim kundër, dhe këto mendime mazhoranca i ka fshehur dhe nuk i ka përmendur në raportin e saj, vetëm në funksion të krijimit të idesë së rreme se të gjitha institucionet e përfshira në procesin e konsultimit kanë qënë pro kësaj nisme.

5.3 Ky veprim përveç se është një mashtrim i hapur i opinionit publik, njëkohësisht cenon rëndë besimin që qytetarët duhet të kenë në procesin legjislativ, dhe është në kufijtë e falsifikimit të dokumentit shtetëror.

5.4 Të gjitha këto veprime janë bërë për të mashtruar opinionin publik vendas dhe ndërkombëtar në shërbim të pushtimit të dhunshëm të Gjykatës Kushtetuese dhe finalizimin e grushtit të shtetit në Republikën e Shqipërisë.

6. Antikushtetutshmëria e ligjit, rrjedh edhe nga përplasja flagrante me tekstin, apo shkronjën e Kushtetutës. Në këtë rast, me miratimin e këtij ligji, manifestohet qartë sjellja arbitrare e pushtetit, nën formën e ligjit. Ky është një rast emblemantik i abuzimit me funksionin legjislativ, si një ves shumë i thellë, deri dhe embrional i tij.

6.1 Legjislacioni nuk është një mjet për t'i dhënë “forcë” çfarëdo fjale, apo çfarëdo vullneti, për çfarëdo lloj interesi. Ligjëbërja është një funksion, kuptimi i të cilit është që t'i japë shoqërisë struktura normative koherente, paqtuëse, të justifikueshme. Me një fjalë: është shprehja e bashkëjetesës, si funksioni më i lartë politik.

6.2 Një ligj i cili nuk e mbart këtë sens, është në vetvete një non-sens nga pikëpamja e legjislacionit; nuk është një rregull social por një arbitraritet, pra një abuzim me funksionin ligjëbërës. Midis “ligjit” dhe “arbitraritetit” ka një kontradiktë të thellë. Ligji e ka të domosdoshme të mos jetë “arbitraritet” dhe ky është një rregull që nuk ka nevojë të shkruhet në tekstin kushtetues. Buron nga vetë koncepti i demokracisë i shenjuar në Preambulën e Kushtetutës.

6.3 E drejta nuk është thjesht “ligji”. Shteti i së drejtës është shumë më tepër sesa “shteti ligjor”. Dallimi midis “shtetit ligjor” dhe “shtetit të së drejtës” është aq i madh, sa është edhe dallimi midis diktaturës dhe demokracisë. Përdorimi i ligjit, kundër natyrës së tij, është shprehja më e rëndë e pavlefshmërisë së tij. Pikërisht ndaj këtij keqpërdorimi, kundrejtohen edhe forcat e “së drejtës” e mbi të gjitha “forcat e së drejtës kushtetuese”.

6.4 Ligji nr. 14/2020, është **shembulli me flagrant i shpërdorimit të funksionit ligjbërës. Asnjë shkak apo motiv me natyrë demokratike apo kushtetuese nuk ka ekzistuar për ta shtyrë Kuvendin, që në urgjencë, agresivitet, në një situatë pothuajse të shkretuar të insitucioneve garantiste kushtetuese, të miratonte një ligj të këtillë.** Madje edhe nën mashtrim të opinionit publik, pa konsultim me aktorë institucionalë, e mbi të gjitha, nën cinizëm ekstrem ndaj autoriteteve ndërkombëtare siç është Komisioni i Venecias. Një ligj i tillë, i miratuar në situata të rrëmbimit psikologjik, në vetvete është i padrejtë, jo në përputhje me atë çfarë kërkojnë ndjesitë publike për paqe sociale dhe me atë çfarë kërkon ambienti politik për vetëfrenim dhe garantim të vlerave themelore të bashkëjetesës sociale dhe ndërtimit të vetë shtetit. Është një ligj kundër natyrës së të drejtës.

6.5 Ligji nr. 14/2020, karakterizohet nga **iracionaliteti** i theksuar. Legjislacioni i vendit, qoftë në planin horizontal e mbi të gjitha në rrafshin vertikal, nuk duhet të prezantojë thyerje të vrazhda, përplasje, mospërputhje. Ky ligj jo vetëm që prish traditën e deritanishme përsa i përket sjelljes institucionale përgjate procesit të betimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, jo vetëm që hap një front përplasjeje legjislative pa asnjë motiv, **krijon përplasje të drejtpërdrejtë me Kushtetutën duke passjellë edhe kaos legjislativ, por sjell si pasojë dhe krijimin e situatave të kontradiksionit, të kaosit institucional dhe alogjizmit juridik.**

6.6 Ligji nr. 14/2020 në vetvete është i **paarsyeshëm dhe qesharak.** Praktikën e nënshkrimit të betimit, dhe dërgimin me postë, do të mund ta bëjnë hipotetikusht shumë subjekte, madje edhe njëherazi. Ata që dëshiron mazhoranca dhe ata që nuk i dëshiron. Do të krijoheshin situata aq qesharake sa vet propozimi i kësaj nisme, për të saktësuar se cila letër e shkruar betuese ka ardhur; cila ka ardhur më shpejt; apo cila është nisur më shpejt. Këto situata sjellin veçse rrënim të solemnitetit, seriozitetit, dhe mungesë legjitimitetit të aktit sublim të betimit.

6.7 Ligji nr. 14/2020 në vetvete është i **padrejtë.** Pa arsye, pa motiv, pa shkak, por thjesht për të zgjeruar pushtetin e vet, një mazhorancë në Kuvend, kërkon të uzurpojë diçka që nuk i takon as me ligj, e as me Kushtetutë. Nëpërmjet këtij akti ligjor, mazhoranca në Kuvend, nuk e fsheh aspak mungesën e delikatesës në rrëmbimin jo thjesht të një kompetence të qartë të Presidentit, por bashkë me të, të rrëmbimit të vetë organit më të lartë mbrojtës të Kushtetutës siç është Gjykata Kushtetuese. Padrejtësia e këtij akti ligjor është e shprehur në mënyrë arrogante dhe jashtë çdo skrupulli politik.

V. Mbi rëndësinë formale dhe substanciale të realizimit të betimit para Presidentit të Republikës, si kërkesë e pashmangshme e Kushtetutës.

1. Gjykata Kushtetuese është shprehur në jurisprudencën e saj se, hartuesit e Kushtetutës e konceptuan rolin e Presidentit *si atë të arbitrit, të moderatorit të pushteteve e të rregullatorit, si një figurë neutrale, me një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e krizave, në balancimin e pushteteve, si dhe*

në kryerjen e funksioneve të tyre respektive. Në aspektin e përgjithshëm, Gjykata, për sa i përket pozicionit kushtetues të Presidentit, ka theksuar se kompetencat e tij janë përcaktuar në zbatim të parimit të shtetit të së drejtës. Parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkalluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore¹².

2. Ndaj dhe parashikimi i nenit 129 të Kushtetutës, mbi kryerjen e betimit para Presidentit të Republikës, **nuk përmban vetëm aspektin formal, honorifik dhe ceremonial**, por lidhet me **ushtrimin e kompetencave thelbësore të Presidentit të Republikës**, në:

- krijimin e besimit se personi që po betohet ka gatishmërinë, vullnetin dhe ndërgjegjësimin e nevojshëm për marrjen përsipër të detyrës për të cilën ai është emëruar/zgjedhur;
- vlerësimin, për aq sa i lejohet, i procesit të ndjekur për përzgjedhjen apo emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

3. Betimi, është një garanci për mbajtësin e pushtetit publik - vetë shtetasit e Republikës së Shqipërisë, që lidh subjektin që merr një funksion të rëndësishëm shtetëror, me angazhimet që i janë deleguar organeve përmes Kushtetutës. Si i tillë, akti i betimit, nuk tregon vetëm për nga përmbajtja angazhimin e individit që merr detyrën për të përmbushur atë konform ligjit themeltar të shtetit dhe ligjeve të tjera në fuqi, por për nga forma, ceremoniali, **pra vetë kryerja e këtij akti betimi para Kreut të Shtetit si përfaqësues i Unitetit të Popullit, është element thelbësor përmbajtësor, që tregon gatishmërinë dhe ndërgjegjësimin në marrjen përsipër të kësaj detyre.**

4. Nga këndvështrimi kushtetues, Kushtetuta kuptohet si normë supreme e Shtetit dhe mbi të bazohet struktura e shtetit, prandaj betimi është konfiguruar si një "respektim i vërtetë" i Kushtetutës si një normë supreme. Betimi është kusht për ushtrimin legjitim të detyrës, që për të paktën 30 vitet e fundit, është konsideruar si akt individual.

Edhe në rastet e betimit të Kryeministrit, ministrave pjesë e kabinetit të sapoformuar qeveritar, secili prej tyre betohet me vete.

Prania dhe zhvillimi i betimit sipas një procedure dhe ceremoniali tek autoriteti shtetëror, në këtë rast tek Kreu i Shtetit, tregon:

¹² Vendimi nr. 10, datë 26.02.2015 i Gjykatës Kushtetuese.

- **ndërgjegjshmërinë dhe kuptueshmërinë** e personit që kryen betimin mbi veprimet që po ndërmerr;
- krijon bindjen e Kreut të Shtetit se ky person **nuk po e kryen këtë veprim** duke qenë i **mashtruar, i kanosur, në lajthim** ose për shkak të **nevojës së madhe**, ç'ka do të sillte pavlefshmërinë e tij, si për çdo veprim tjetër juridik.

Sipas përmbajtjes së ligjit nr. 14/2020, e gjithë rëndësia e këtij momenti që lidhet me kërkesën Kushtetuese që procesi i betimit të bëhet para Presidentit, zhvleftësohet dhe nuk është më e nevojshme.

Betimi sipas këtij ligji humbet tërësisht rëndësinë e tij, dhe mund të kryhet kudo, pa nevojën për prezencën e asnjë autoriteti shtetëror, duke legjitimuar kështu rrënimin e të gjithë autoritetit të shtetit dhe duke cenuar rëndë vet legjitimitetin dhe autoritetin e personit që merr një detyrë kaq të rëndësishme në Republikën e Shqipërisë.

5. Përderisa ndodhemi përpara dispozitave ligjore që nuk mbështeten në parimet dhe rregullimet e specifikuar kushtetuese, por në tejkalime jashtë parashikimeve kushtetuese, si në formë ashtu edhe në përmbajtje, **është prekur, veç të tjerash, edhe parimi i shtetit të së drejtës**, i shprehur me përparësinë e normave të Kushtetutës në raport me normat e tjera ligjore. Ky është një qëndrim i konsoliduar nga vet Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj¹³.

6. Betimi përpara Kreut të Shtetit, është një garanci më shumë për njohje të parimit të sovranitetit kombëtar dhe lirive e të drejtave themelore të popullit. Për rrjedhojë, edhe anëtari i Gjykatës Kushtetuese, që do të shërbejë në ushtrimin e funksionit të tij si garant i Kushtetutës, legjitimitetin që i rrjedh nga Kushtetuta, dhe vullnetin për ta ushtruar atë nuk mundet ta deklarojë dhe ta garantojë askund tjetër veçse para Kreut të Shtetit personalisht.

7. Betimi para Presidentit të Republikës, përveç pasojave të kërkuara institucionale për fillimin e ushtrimit të detyrës, sjell garanci morale, dhe forcim të angazhimit për mbrojtjen e detyrimeve të paraqitura në tekstin e Kushtetutës.

VI. Mbi shkeljen e legjitimitetit të Gjykatës Kushtetuese, si organ unik.

Përmbajtja e ligjit nr. 14/2020, përbën një goditje të rëndë ndaj nenit 124, paragrafët 1 dhe 2 të Kushtetutës, të kombinuara me nenin 86, paragrafi 1, i Kushtetutës. Këto dispozita përbëjnë elementin bazik që inkuadron esencën dhe ekzistencën e Gjykatës Kushtetuese. Bëhet fjalë pikërisht për elementin e legjitimitetit. Ky element është themeli i çdo institucioni apo autoriteti në demokraci. Besueshmëria, pranueshmëria e vendimmarrjes, konsiderimi si gur udhërrëfyes të

¹³ Vendim nr. 25, datë 5.12.2008 i Gjykatës Kushtetuese.

bashkëjetesës në demokracinë liberale të autoriteteve më të larta kushtetuese, janë ndjesi të cilat burojnë nga fakti nëse këto autoritete janë, apo jo, legjitime.

Në shumë raste, legjitimiteti buron drejtpërdrejt nga sovranit. Është sovranit, i cili me anë të momentit të zgjedhjes, u përcjell atyre legjitimitetin e nevojshëm. Në raste të tjera, të derivuara, ky legjitimitet jepet prej autoriteteve që sipas Kushtetutës, iu njihet ky (përfaqësimi i sovranit). Presidenti, sipas nenit 86/1 të Kushtetutës, është “Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit”. Është ky parashikim kushtetues, që i jep pozicionin “superpartes” dhe të privilegjuar Presidentit të Republikës.

Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese, sipas formulës së propozuar, me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, përballlet me një tjetër mekanizëm të kompozimit. Thelbi i këtij mekanizmi sjell avantazhe sepse eliminon konfliktet e panevojshme të mëparshme, duke vendosur kufij të qartë ndarës mes tashmë 3 autoriteteve: Presidentit, Kuvendit, Gjykatës së Lartë.

Por nga ana tjetër, sjell dhe rrezikun që Gjykata Kushtetuese të mund të parcializohet që në stadin fillestar të kompozimit të saj. Duke krijuar kështu rrezikun e ndasive të thella mes anëtarëve, psikozë kjo që mund t'i shoqërojë anëtarët individualë të saj gjatë gjithë kohëvazhdimin në detyrë.

Nga ana tjetër, neni 124, paragrafët 1 dhe 2 të Kushtetutës, e ngarkojnë Gjykatën Kushtetuese, pra gjithë anëtarësinë e saj, në mënyrë integrale në një mision të përbashkët: garantimin e Kushtetutës dhe nënshtrimit ndaj saj. Anëtarët individualë të Gjykatës Kushtetuese nuk do të mund ta kryejnë asnjëherë këtë mision, nëse ata në sy të aktorëve publikë, politikë dhe qytetarëve, do të shihen si vartës apo përçues të secilit nga të 3 organet që i kanë zgjedhur/emëruar.

Gjithçka do të ishte një hipokrizi institucionale dhe publike. Çdo zgjidhje apo vendimmarrje e tyre do të ishte e paragjykuar. Për këtë arsye, është e domosdoshme që pavarësisht se momentet fillestare të emërimit janë të parcializuara, momenti fundor duhet të jetë përbashkues.

Nëpërmjet procedurës solemne të betimit, betimi duhet bërë para një autoriteti që pranohet të jetë përfaqësues i unitetit të sovranit dhe Presidenti i Republikës është i vetmi institucion që sipas Kushtetutës e mishëron këtë unitet. Për sa kohë që Gjykata Kushtetuese mbron sovranin (Kushtetutën e tij) dhe për sa kohë që Presidenti është përfaqësues i unitetit të sovranit, atëherë pikë takimi i vetëm i sovranit, është pikërisht që betimi të bëhet para Presidentit. Kjo siguron unitetin dhe legjitimitetin e Gjykatës Kushtetuese.

Një anëtar i Gjykatës Kushtetuese, në fazat fillestare mund të jetë i zgjedhur/emëruar nga Kuvendi, Presidenti apo Gjykata e Lartë, por para se të marrë detyrën, ai duhet jo vetëm të perceptohet, por të legjitimohet si gjyqtar në shërbim të Sovranit. Kjo premisë është e domosdoshme sepse:

- Së pari, garanton unitaritetin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, pra i barazon ata në status dhe autoritet;
- Së dyti, misioni i nënshtrimit ndaj dhe garantimit të Kushtetutës së Sovranit mund të bëhet vetëm nga një trupë integrale dhe unitare e cila duhet të besojë dhe të besohet se i shërben interesave të Sovranit.
- Çdo devijacion nga kjo zgjidhje, thjesht do të krijonte tensione dhe acarim, që do të përcillej tek Sovrani, e kështu misioni i Gjykatës Kushtetuese do të përmysej.

Por këtë arsye, nenet 86/1, 124, paragrafët 1 dhe 2, dhe 129 të Kushtetutës, janë të lidhura së brendshmi nga ky fill logjik i natyrshëm. Cenimi i njërës prej këtyre dispozitave cenon automatikisht edhe të tjerat, duke prishur kështu harmoninë logjike dhe natyrale mes tyre.

Në përfundim,

Rregulli kushtetues i ngulitur në nenin 129 të Kushtetutës, kurrsesi nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohej me akte juridike që dalin në shkelje të Kushtetutës.

Neni 129 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është një dispozitë që ushtrohet drejtpërdrejt dhe kushtetutëbërësi këtë të drejtë, përmes kësaj dispozite, ia ka atribuar posaçërisht Presidentit të Republikës.

Duke ju referuar të gjitha konstatimeve të mësipërme, ligji nr. 14/2020, bie ndesh me normat kushtetuese që parashikojnë kompetencat e Presidentit në lidhje me betimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Shtimi i pikës 1 në dispozitën ligjore të nenit 8, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese*”, i ndryshuar, nuk mbështetet në parimet dhe rregullimet kushtetuese, por e shkel hapur Kushtetutën.

Kjo shkelje dhe dhunim i Kushtetutës, cenon edhe parimin e shtetit të së drejtës, të shprehur me hierarkinë e normave dhe përparësinë e Kushtetutës, në raport me normat e tjera ligjore.

Për më tepër, ky ligj synon që gjatë procesit të vlerësimit dhe zgjedhjes/emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, nëse Presidenti i Republikës konstaton shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit, ai të mos ketë mundësi t'i evidentojë ato. Kjo nuk është gjë tjetër, veçse tentativa e radhës për kapjen politike të emërimeve në Gjykatën Kushtetuese nga partia shtet, dhe shkatërron besueshmërinë në sistemin e drejtësisë në tërësi.

Presidentit, i kërkohet jo vetëm nga Kushtetuta por edhe nga situata aktuale që të mbrojë në mënyrë energjike vlerat bazike të Kushtetutës dhe demokracisë. Për këtë do të përdorë të gjitha mjetet kushtetuese e ligjore në proporcion me rrezikun e madh që i kanoset bashkëjetesës së qytetarëve, ruajtjes së vetë ekzistencës së shtetit të së drejtës dhe Kushtetutës mbi të gjitha.

Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Për gjithë sa u parashtua më sipër, në bindje të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 85, pika 1 dhe 93 të saj, kam vendosur kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 14/2020 “Për një shtesë në ligjin nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar”.

Ky akt i Presidenti kërkon pikërisht rikthimin e paqes sociale, respektimin e shtetit të së drejtës, kufizimin e ekspansionit të pushtetit të mazhorancës politike në Kuvend e gjetiu, respektimin e kufijve të kompetencës kushtetuese, luajalitetin kushtetues, e në këtë mënyrë, mbrojtjen e interesit më të lartë të popullit shqiptar.

Përmes ndryshimeve të porositura politikisht e të pamenduara të ligjeve që u rikonceptuan në kuadër të Reformës në Drejtësi, po hiqen pak e pak “tullat e ngrehinës”- paketës së ndryshimeve ligjore në kuadër të kësaj reforme.

Ndaj kam besimin se pavarësisht urdhrave partiakë, apo dëshirës për të mos prishur rehatinë e mandatit të deputetit, ky Dekret, arsyet që e shoqërojnë atë, dhe mbështetja popullore që mori nënshkrimi i këtij akti nga populli sot, do ju bëjë të reflektoni!

Do t'ju bëjë të reflektoni mbi nevojën për të mbrojtur në emër të popullit tonë, në emër e për hir të fëmijëve tuaj - fëmijëve tanë: Kushtetutën, shtetin e së drejtës, demokratik e social, që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut; dhe me bindjen e thellë tek drejtësia, siç e kërkon Kushtetuta e vendit tonë që duhet të udhëheqë ushtrimin e funksionit për secilin nga ne, do të reagoni duke mos lejuar cenimin e integritetit të Gjykatës Kushtetuese.

Me respekt për parimet themelore të një shoqërie demokratike,

